



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 51

Tiranë – E enjte, 26 mars 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.244, datë 26.3.2020	Për vendosjen në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të objektit të ish-universitetit “Kristal”..... 3251



VENDIM
Nr.244, datë 26.3.2020

PËR VENDOSJEN NË DISPOZICION
TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE TË
OBJEKTIT TË ISH-UNIVERSITETIT
“KRISTAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 16, të nenit 3, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për

përballimin e situatës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, të objektit të ish-universitetit “Kristal”, me vendndodhje në Mëzez, Tiranë, zona kadastrale 2679, sipas kartelave të pasurive dhe planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë të gjitha masat, në varësi të situatës, për përshtatjen e pasurisë së përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, në një strukturë karantine ose spitalore, si dhe të përllogarisë fondin për të kryer investimet e nevojshme.

3. Objekti i ish-universitetit “Kristal” mbetet në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 28 lekë